

Datë __/__/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHËRBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Hartimi i planit vendor të veprimit për energjinë dhe klimën”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 71351611-9

Vlera e fondit limit: 6,077,777.7 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë shtatë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 9 muaj

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 3**;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 10**;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1, si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 30% të fondit limit vlerës së përlogaritur të kontratës**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2, c) dhe pika 3 e VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një **vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi për të dëshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit të tyre:

Stafi kryesor i punësuar dhe i reflektuar në listëpagesë:

- **1 (një) Ekspert Kryesor për energjinë dhe klimën /Menaxheri i Projektit**

I cili duhet të ketë:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Master ose kualifikime të tjera ekuivalente në fushën energjetike
- Përvoja profesionale: mbi 10 vite eksperiencë në menaxhimin e projekteve në sektorin energjetik, përfshirë eficiencën e energjisë dhe burimet e rinovueshme, si dhe eksperiencë në hartimin e studimeve të fizibilitetit.

- **1 (një) Ekspert për ndryshimet klimatike**

Me kualifikim universitar Të ketë

I cili duhet te kete:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: master ose ekuivalent në inxhinieri mjedisi shkenca natyrore ose të ngjashme.
- Përvoja profesionale: mbi 5 vite eksperiencë në sektorin e klimës, energjisë, mjedisit si pjesëmarrje dhe kontribut në projekte që lidhen me analizën dhe përgatitjen e politikave dhe strategjive mbi përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Staf mbështetës (i punësuar ose i kontraktuar):

- **1 (një) Auditues energjetik në ndërtesa dhe instalime industriale (i licensuar)**

I cili duhet te kete:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: master ose ekuivalent në inxhinieri.
- Përvoja profesionale: eksperiencë 3 vjeçare në auditime energjetike, modelim të konsumit, identifikim masash për efikasitet dhe energji të rinovueshme.

- **1 (një) Inxhinier mekanik/transport**

I cili duhet te kete:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Master, Inxhinieri Mekanike /Transport
- Përvoja profesionale: mbi 5 vite eksperiencë në planifikimin e transportit urban.

- **1 (një) Inxhinier elektrik**

I cili duhet te kete:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Master në inxhinieri elektrike,
- Përvoja profesionale: mbi 5 vite eksperiencë për sistemet e prodhimit dhe konsumit

- **1 (një) Ekspert Finance**

I cili duhet te kete:

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Master në finance,
- Përvoja profesionale: mbi 5 vite eksperiencë në fushën e financës

- **1 (një) Ekspert Juridik për Legjislacionin Mjedisor**

- Kualifikim (diplomë universitare) në: Master në Drejtësi dhe eksperiencë në legjislacionin mjedisor, energjetik dhe klimatik.

- **1 (një) specialist për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave,**

I cili duhet te kete:

➤ Kualifikim (diplomë universitare) në: Bachelor ose më të lartë

Për stafin e mësipërm duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Kontratë pune e vlefshme
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Me certifikatë/ dëshmi profesionale ose diplomë.

Argumentimi: Kategoritë e kërkuara janë bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar). Pikën 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kërkesa specifike për stafin të kërkuar është përcaktuar në kuadër të termave të referencës që janë të nevojshme për të realizuar objektin e shërbimit nga ku përcaktohet qartazi dhe profili i stafit të nevojshëm që është kërkuar.

- **1(një) Ekspert Kryesor për energjinë dhe klimën /Menaxheri i Projektit**

Të ketë eksperiencë në koordinimin e ekipeve ndërdisiplinore dhe përgatitjen e dokumenteve strategjike të ngjashme kombëtare ose vendore. Ky ekspert duhet të zotërojë diplomë universitare të nivelit Master ose kualifikime të tjera ekuivalente në fushën energjetike. Ai do të udhëheqë procesin e hartimit të planit dhe do të mbikëqyrë hartimin e masave/veprimeve specifike duke përmbyllur kërkesat e AK, do të japë orientimet më të përshtatshme për Bashkinë e Tiranës në sektorin energjetik dhe do të mbikëqyrë aktivitetet e parashikuara të planit, duke garantuar që produkti final të jetë në përputhje me kërkesat e dokumentit. Do të garantojë përputhjen e Planit për Energjinë dhe Klimën me dokumentat kombëtarë në fuqi. Gjithashtu, vlerësohen përvoja të mëparshme ose bashkëpunimet me donatorë ose organizata të huaja.

Gjykohet të ketë eksperiencë pune mbi 10 vjet, për arsye se drejtuesi i projektit ka përgjegjësinë e menaxhimit të stafit të punës së projektit dhe të drejtimit teknik të aktivitetëve. Për këtë, kërkohet të ketë eksperiencë relativisht të gjatë punë pasi dhe fusha e aktivitetit është mjaft specifike. Periudha 10 vjeçare i jep mundësi që personi që do të propozohet të ketë pasur eksperiencë në drejtimin e projekteve të ngjashme dhe të ketë aftësitë e duhura menaxheriale.

Fusha e energjisë në përfaqësimin e platformave dhe strategjive kombëtare ka një rol kyç dhe për këtë arsye ekspertët që kanë punuar me të duhet të kenë njohuri në zhvillimet dhe ecurinë e tyre në vendin tonë. Kjo është një arsye që bën eksperiencën 10 vjeçare të domosdoshme për të kuptuar dhe njohur kërkesat në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të fushës, që duhet të zbatohen në nivel lokal.

- **1 (një) Ekspert për ndryshimet klimatike**

Eksperti i ndryshimeve klimatike do të luajë rol në ofrimin e mbështetjes, por edhe hartimit të masave për sektorin e Energjisë dhe Klimës. Do të ofrojë analiza mbi ndikimet klimatike në sektorët

kryesorë (energji, transport, ndërtesa, mbetje, bujqësi dhe planifikim urban) dhe do të propozojë masa të qëndrueshme që minimizojnë ndikimin e klimës në komunitete si dhe detyra të tjera të cilat kërkojnë ekspertizë profesionale.

Eksperienca 5 vjeçare kërkohet për të garantuar që eksperti i ndryshimeve klimatike ka kaluar nga faza akademike në atë praktike. Ka njohuri të plota në proceset e raportimit të gazeve me efekt serrë, menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe integrimin e masave të përshtatjes në politika lokale.

Staf mbështetës (i punësuar ose i kontraktuar):

- **1 (një) Auditues energjetik në ndërtesa dhe instalime industriale (i licensuar)**

Do të sigurojë vlerësime mbi performancën e përgjithshme energjetike sektorëve të lartpërmendur, duke dhënë rekomandime konkrete për ndërhyrjet që duhen parashikuar në plan.

Siguron njohuri të thelluara mbi principet shkencore dhe teknike që janë të domosdoshme për të kuptuar auditimin energjetik. Ai do të sigurojë inputet teknike për ndërtimin e skenarëve të kursimit të energjisë dhe për planin e investimeve të Bashkisë Tiranë.

Eksperienca 3 vjeçare garanton që aktivitetet e parashikuara në plan në kuadër auditimi të realizohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar në fuqi. Një auditues me 3 vite përvojë pune ka zhvilluar aftësi praktike në identifikimin e konsumit të energjisë dhe në analiza të detajuara të sistemeve energjetike. Kjo përvojë është thelbësore për të realizuar auditimet e sakta në kuadër të efikasitetit energjetik dhe promovimin e burimeve të rinovueshme në sektorin e ndërtimit dhe industrisë.

- **1 (një) Inxhinier mekanik/transport**

Do të orientojë planin për mënyrën e lëvizshmërisë dhe integrimin e mjeteve alternative në territorin e Bashkisë së Tiranës. Eksperti për transportin do të trajtojë të gjitha aspektet e ndikimit të transportit në klimë dhe energji, si dhe do të ofrojë masa konkrete në lidhje me reduktimin e ndikimit të tyre në mjedis. Gjithashtu masat do të jenë edhe për përmirësimin e sistemeve të transportit duke integruar teknologji të reja dhe zgjidhje që kontribuojnë në reduktimin e emetimeve.

Duhet të ketë përvojë pune mbi 5 vite në këtë fushë për arsye se do të kryejë planifikimin e transportit urban, analizë dhe modelim të sistemeve të transportit përmes identifikimit të nevojave dhe sfidave specifike të qytetit.

- **1 (një) Inxhinier elektrik**

Do të kryejë analiza të konsumit dhe furnizimit me energji si dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në rrjet. Eksperienca 5 vjeçare garanton njohuritë e duhura për analizimin e kapacitetit e rrjetit lokal për integrimin e burimeve të rinovueshme (fotovoltaikë, pompa nxehtësie), si dhe vlerësimin e mundësive e përdorimit të sistemeve “smart grid”, që do të ndihmojë në hartimin e masave për uljen e konsumit përmes automatizimit të ndriçimit publik. Ky rol është i rëndësishëm për shkak të synimit të Bashkisë Tiranë për të bërë kalimin e plotë në teknologji LED dhe inteligjente, si dhe për të krijuar një sistem më të qëndrueshëm energjetik në nivel vendor.

- **1 (një) Ekspert Finance**

Të analizojë nga këndvështrimi financiar skenarët dhe masat e propozuara nga plani, duke marrë në konsideratë buxhetin vjetor të Bashkisë së Tiranës. Eksperienca 5 vjeçare në fushën e financës garanton planifikimin efikas të burimeve të financimit. Hartimi i analizës kosto-përfitim për çdo skenar të PVEK-së dhe hartimi i masave të kostuara, kërkon njohuri të thelluara dhe përvoja të ngjashme. Ai është thelbësor për të garantuar që plani të jetë jo vetëm teknikisht i vlefshëm, por edhe ekonomikisht i qëndrueshëm dhe i zbatueshëm.

- **1 (një) Ekspert Juridik për Legjislacionin Mjedisor**

Do të ofrojë interpretimin ligjor dhe sigurimin që PVEK të jetë në përputhje me kuadrin kombëtar dhe direktivave të transpozuar në fushën e energjisë

Eksperti juridik duhet të ketë eksperiencë mbi 5 vite eksperiencë, për të garantuar interpretim të saktë të kërkesave ligjore, përfshirë detyrimet e raportimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional midis pushtetit vendor dhe atij qendror. Ky rol është i domosdoshëm për përgatitjen e dokumenteve të harmonizuara dhe për shmangien e mospërputhjeve ligjore gjatë zbatimit të planit.

- **1 (një) specialist për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave**

Ky specialist do të kryejë procesin e krijimit, përpunimit dhe vizualizimit të bazës së të dhënave, hartimin e grafikëve dhe hartave të nevojshme për planin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Gjithashtu Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet përkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të

paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jete kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën si mesiper, në përputhje me parashikimet e nenit 4 dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

SHËNIM: Në Termat e Referencës dhe Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Hartimi i planit vendor të veprimtari për energjinë dhe klimën”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personat përgjegjës për prokurim.